REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës Nr.03/L-149 , Neni 11 ,Agjencia kundër Korrupsionit shpall

KONKURS

Organizata: **Agjencia kundër Korrupsionit**
Titulli i postit: **Shef i Divizionit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit**

Shifra e postit: **DPK**
Koeficienti i postit: **9**
Paga : **322 €**

Detyrat dhe përgjegjësit

- Parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksionit publik,
- Përgatitjen e pjesës së Raportit që ka të bëjë me mbikëqyrjen e pasurive, konfliktin e interesave dhe pranimin e dhuratave,
- Përmbushjen e detyrave tjera në përputhje me mandatin e këtij departamenti.
- Divizioni i Parandalimit të Konfliktit të Interesit udhëhiqet nga Shefi i Divizionit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.
- Shefi i Divizionit udhëheq punën e Divizionit dhe zyrtarëve të tij, ndan detyrat dhe mbikëqyr realizimin e tyre, për punën e divizionit i raporton Drejtorit të Departamentit të Parandalimit si dhe kryen detyra të tjera me kërkesën e Drejtorit të Departamentit të Parandalimit dhe Drejtorit të Agjencisë.

Kualifikimet e nevojshme:

- Kandidati duhet të ketë përgatitje universitare, drejtimi juridik, ekonomik .
- Të ketë dy vite përvojë pune profesionale, preferohet përvoja në hartimin dhe interpretimin e legjislacionit,
- Kandidati duhet të ketë njohuri të mira në lidhje me legjislacionin në fuqi,
- Kandidati duhet të jetë në gjendje të punojë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti.
- Kandidati/ja duhet të jetë i gatshëm të punojë jashtë orarit nëse është e nevojshme,
- Të jetë banor/e i përhershëm i Kosovës,
- Posedimi i patentë shoferit është i dëshirueshëm,
- Njohja e punës me kompjuter Word-i, Excell-i,Power Point, interneti, përpunimi i tekstit ,janë të domosdoshme.
- Kërkohet njohuri e shkëlqyer e gjuhës shqipe dhe /ose e gjuhës serbe, ndërsa njohja e gjuhës angleze është përparësi.

INFORMATAT E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Kohëzgjatja e kontratës për të gjithë nëpunësit civilë në pozitat e karrierës është e përherëshme me periudhë provuese dymbëdhjetë (12) muaj . Agjencia kundër Korrupsionit ofron mundësi të barabarta punësimi dhe mirëpret kërkesat e pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë dhe të femrave.
Politika e punësimit të drejtë të gjitha komuniteteve të Kosovës, do të zbatohet në strukturën e stafit të Agjencisë. Kandidatët e përzgjedhur do t'i nënshtrohen një testimi me shkrim, në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët të cilët tregojnë rezultatet në testim me shkrim.

PROCEDURA E KONKURIMIT

Formulari për konkurrim mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Agjencisë kundër Korrupsionit në Prishtinë (rruga"Nazim Gafurri" nr. 31). Formulari zyrtar i konkurrimit duhet të dorëzohet së bashku me letër motivimin dëshminë për kualifikimin shkollor, specializimin, kurset e ndjekura, përvoja e punës dhe referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe të pakompletuara me të dhënat e kërkuara, si dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, do të konsiderohet i pavlefshëm.
Konkursi mbetet i hapur 15 ditë ,duke filluar nga data 08.11.2010 ,ndërsa dita e fundit për aplikim është 22.11.2010.
Kërkesat e dërguara pas datës së fundit për aplikim nuk do të merren parasysh ndërsa kërkesat e pakompletuara nuk do te shqyrtohen.

Kërkesa mund të dozohet në recepcionin e ndërtesës së Agjencisë kundër Korrupsionit në Prishtinë (rruga"Nazim Gafurri" nr. 31) ose me postë, si dhe në Zyrën e Personelit nr .9 kati i parë. Për informata shtesë mundë të telefononi në telefonin: 038 518-942 lok 10 715 ose 038 518-924 lok 10 707 .

Shërbimi Civil i Kosovës i shërben të gjithë popullit të Kosovës dhe mirëpret aplikacionet prej meshkujve dhe femrave prej të gjitha komuniteteve kosovare .